


REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Data/Date/Datum:	04.09.2023
Për/To/ Za:	Alban Hyseni, Kryetar i Komunës së Gjilanit
Cc:	
Përmes/ Through/ Preko	Qendra për Shërbime me Qytetarë
Nga/From/Od:	Ardian Foniqi, në cilësi të Zyrtarit Përgjegjës për Konsultime Publike
Lënda/ Subject/Tema:	Raport i Konsultimeve Publike me Qytetarë për Planifikimin e Buxhetit 2024-2026

I nderuar Kryetar,

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale për Konsultime Publike në Komunë, neni 5 pika 5 e këtij udhëzimi, po ua paraqes raportin e konsultimeve publike me qytetarë për Planifikimin e Buxhetit për periudhën 2024-2026 i mbajtur me gratë, rininë, fermerët, profesionistë të kulturës dhe sportit, profesionistë të arsimit, profesionistë shëndetësor, personat me nevoja të veçanta, komunitetin jo-shumicë, këshillat lokalë të fshatrave, lagjet Dardania 1-2, Dheu i Bardhë, Reshat Ymeri, qendra e qytetit, rruga e Prishtinës, Arbëria, Zabeli i Sahit Agës, Iliria, Lagja 8 dhe Hamdi Kurteshi. Diskutimet publike kanë filluar nga data 24.08.2023 dhe kanë përfunduar më datë 31.08.2023.

Në këto dëgjime publike me qytetarë morën pjesë kryetari i komunës z. Alban Hyseni, UD Drejtor i Financave Ilmi Limani, Drejtoresha për Administratë të Përgjithshme Doruntina Hasani, Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër Bekim Salihu, Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport Kushtrim Zeqiri, Drejtori i Bujqësisë Bajram Isufi, Drejtori i Urbanizmit Ali Arifi si dhe këshilltarët komunal Ardita Ukshini dhe Blerim Haziri.

Gjatë këtyre diskutimeve publike kanë marrë pjesë mbi 200 qytetarë.

Kryetari i Komunës ka prezantuar projekt-buxhetin për periudhën 2024-2026, duke u fokusuar në rritjen e buxhetit për këtë vit në krahasim me vitet e kaluara. Kryetari poashtu ka prezantuar kufijtë buxhetor për 3 vitet e ardhshme sipas së cilës për vitin 2023 ishte 3 milion euro më i lartë, ndërsa në vitin 2024 do të kemi rreth 37 milion euro, në vitin 2025 mendojmë se do të jetë 39 milion euro, dhe në vitin 2026 buxheti do të jetë afër 41 milion euro.

Gjatë diskutimit publik me gratë u kërkua të sigurohet një hapësirë për organizimin e aktiviteteve të gruas pensioniste, si dhe një fond i përvitshëm dhe i veçantë për këto aktivitete. Kryetari u zotua për angazhimin e stafit të tij lidhur me sigurimin e një hapësire për zhvillimin e aktiviteteve të tyre, ndërsa sa i përket kërkesës për krijimin e një fondi të veçantë për këtë kategori, ua sqaroi se duhet të aplikojnë përmes thirrjeve publike për subvencionim sipas procedurave dhe hapave ligjor.

Gjatë diskutimit publik me rininë, theksi është vënë në rritjen e buxhetit për rini, përkatësisht faktit që për vitin e ardhshëm Drejtoria e Kulturës do të ketë rreth 50.000 euro më shumë se këtë vit.

Fermerët u informuan se për vitin 2024, buxheti do të jetë rreth 37 milion euro që është me rritje rreth 5 milion euro, e që do të ndahet në kategori të ndryshme duke përfshirë edhe subvencionet në bujqësi.

Nga fermerët u parashtruan pyetje lidhur me hapjen e rrugëve të reja, subvencionet për shpeztari, si dhe parandalimin e keqpërdorimeve të subvencioneve në bujqësi.

Nga takimi me përfaqësues të kulturës dhe sportit u diskutua se buxheti është shumë më i lartë se në vitin e kaluar ku në bazë të kërkesave të profesionistëve të kësaj fushe, i njejtë do të ndahet në lëmi të ndryshme të kulturës dhe sportit. Ndër të tjerash, u theksua se do të krijohet instituti për artin bashkëkohor, sistemi i ngrohjes në teatër, projekti i stadiumit ndihmës dhe qendra e kulturës.

Nga pjesëmarrësit u kërkua shtimi i investimeve në shtëpi të kulturës në fshatra, hapja e thirrjes publike për funksionalizimin e objekteve të kulturës siç është Sahat Kulla, riparimi i teatrit, dhënia e bursave për sportistët e dalluar, mbështetje për botime të librave, etj.

Në takimin me profesionistë të arsimit, ndër të tjerash u kërkua që të zbatohet obligimi ligjor që këshillat e prindërve të kenë një sallë ku do të mund të zhvillojnë takimet e tyre, të investohet në shkollën e fshatit Bresalc, të pajisen shkollat me dalje emergjente në rast rreziqesh eventuale, etj.

Nga ana e profesionistëve shëndetësor është kërkuar të mbahet një konferencë rajonale e mjekëve, blerja e autoambulantës dhe një kombi për bartjen e personelit mjekësor, zbatimimi i kontrollave sistematike të fëmijëve në shkolla dhe çerdhe, ndërtimi i një AMF-je në lagjen Fidanishtja, etj.

Personat me nevoja të veçanta u informuan lidhur me thirrjen publike për punësim të përkohshëm me subvencionim nga komuna me pagë prej 300 euro, si dhe lidhur me hapjen e procedurave të rekrutimit për punësim në organet komunale. Është kërkuar që të ketë një hapësirë për qëndrim ditor për këtë kategori, me qëllim të socializimit dhe aftësimit të tyre.

Gjatë diskutimit publik me komunitetin jo-shumicë, të mbajtur në fshatin Shillovë, kryesisht kërkesat e qytetarëve kanë pasur të bëjnë me asfaltimin e rrugës me shtresën e dytë sepse që nga viti 2014 që është shtruar shtresa e parë askush nuk është marrë me këtë problem. Si probleme shtesë janë ngritur edhe parkimi i veturave në trotuar të shkollës, mungesa e ujësjellësit, ujërat zeza të shkaktuara nga reshjet atmosferike, si dhe është kërkuar që sa më parë të themelohet këshilli i fshatit.

Përfaqësuesit e këshillave lokale të fshatrave, kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me mosbashkëpunimin e organeve të komunës me kryetarët e fshatrave. Të njëjtit kanë kërkuar asfaltim rrugësh në fshatra, rregullimin e ujësjellësit, trotuareve, etj.

Në takimin me banorët e lagjeve të qytetit, është kërkuar rregullimi i parkut në Dardani, lirimi i trotuareve afër Inkubatorit të Biznesit, emërtimi i një rruge në lagjen Dardania me emrin Alban Ajeti, themelimi i këshillit në lagjen e 8-të, rregullimi i rrugës Tahir Sinani, uzurpimet e pronave komunale dhe pastrimi i mbeturinave mbrapa shkollës së muzikës.

Qytetarët pranuan përgjigje nga ana e Kryetarit të Komunës, Drejtorëve komunal, si dhe në raste të caktuara edhe nga ana e zyrtarëve përgjegjës sipas kompetencave dhe pozitive që ushtrojnë.

Me respekt,

